



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 04.03.2026

NR.09/ 2230 /2026

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-25-11219-2-3-6/C723 & KKHE 25-077-2-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Kompania E Sigurimeve Të Përgjithshme Siguria, Rr. Qamil Hoxha, Nr.51, PRISHTINË, 810495102, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara më poshtë:

Sigurimi i veturave të komunes Hani i Elezit -(Administrata ,QKMF-se Njesia se Zjarrfikësve) me numër identifikues: 659-25-11219-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Sigurimi i automjeteve të Komunes Hani i Elezit

No.	Lot
1	Sigurimi i veturave të komunes Hani i Elezit -(Administrata ,QKMF-se Njesia se Zjarrfikësve)

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **4,838.97 €**; [Katër mij e tetqind e tridhjet e tetë Euro /97 cent]

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

-Data e Përfundimit është: **12 muaj apo 1 vit nga nënshkrimi i saj mes palëve**

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Avdush Bajramaliu
Pozita:	Zyrtar i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	04.03.2026
Vula:	



Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Adnan Rudari
Pozita:	Perfaqesues me autorizim
Nënshkrimi:	
Data:	04.03.2026
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-11219-2-3-6/C723

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhe në, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <i>[nga data e nënshkrimit te kontrates ne mes te palëve]</i> .
	6.4	Data e Përfundimit është: 12 muaj apo 1 vit nga nënshkrimi i saj mes palëve
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <i>Prishtinë ose pika më e afërtë</i>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit do të caktohet me Vendim nga ZKA
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% në ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10 % të çmimit final të kontratës .
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vleres se kontrates per 13 muaj
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Kompania e sigurimit e ka obligim sigurimin e veturave sipas specifikimeve dhe çmimeve të dhena në përshkrimin e çmimeve. Referoju përshkrimin të çmimit
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <i>Pagesa do të bëhet pas realizimit të shërbimit konform ofertës dhe obligimeve që merren me këtë kontrat</i> <i>Pagesa do të bëhet brenda afati ligjor</i>
Kontrolli i kualitetit	17.1	<i>Sigurimi kasko do të mbulohet 100% nga OE (kompania e sigurimit)- dhe sipas kushteve të percaktuar në dosje të tenderit –tek lista e çmimeve.</i> <i>OE-është i obliguar të bëjë sigurimin e veturave të AK-ne sipas rregullave ligjore për tu regjistruar mjeti motorrik</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>AK-gjegjesisht menaxheri i kontrates kontraollon cilesin e realizimit të shërbimit – që shërimi të realizohet konform kësaj kontrate dhe veturat të jenë në gjendje të rregullt saj përkat policave të sigurimit dhe pagesave tjera për të dalur në teren</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit të Elezit ose përmes procedurave alternative të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve-procedurat e ndërmjetësimit me pajtimin e të dy palëve

Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykatën Komerceiale në Prishtinë/ në pajtim me ligjin në Kosovë].</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara në Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</p>
---	------	---